

FJALA E GUVERNATORIT

Viti që lamë pas ishte, në tërësinë e tij, një vit pozitiv për ekonominë shqiptare.

Përballë një ambienti të huaj sfidues, vëllimi i aktivitetit ekonomik vijoi të rritet, duke gjeneruar më shumë punësim e të ardhura për bizneset dhe familjet. Paralelisht me to, treguesit kryesorë të stabilitetit ekonomik, monetar e financiar të vendit, shënuan përmirësim. Inflacioni shënoi një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2024, duke zbritur pranë objektivit tonë prej 3% dhe duke i ofruar ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare një ambient me çmime të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, deficitet buxhetor dhe deficitet e llogarisë korrente qëndruan pranë minimumeve të tyre historike, borxhi i huaj dhe borxhi publik shënuan rënie të mëtejshme, ndërsa parametrat e stabilitetit financiar dhe ato të shëndetit të sektorit bankar qëndrojnë në nivele të mira.

Ky progres ka gjetur konfirmim edhe nga partnerët tanë ekonomikë e financiarë. Viti 2024 pati një sërë lajmesh pozitive për ekonominë shqiptare, por këtu dëshiroj të veçoj tre prej tyre: së pari, Shqipëria nisi zyrtarisht procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian që pritet të kulmojë me plotësimin e aspiratës tonë kombëtare për të qenë zyrtarisht pjesë e familjes së kombeve më të zhvilluara evropiane; së dyti, vendi ynë u anëtarësua në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA) - një hap i cili do të sjellë përfitime reale në formën e reduktimit të kostove të pagesave bankare ndërkufitare; dhe së treti, Shqipëria përfitoi një reduktim të rrezikut të borxhit sovran nga dy agjencitë më prestigjioze të vlerësimit, gjë që ka dhënë përfitime të shpejta e të dukshme në reduktimin e kostove të financimit në tregjet ndërkombëtare.

Si një institucion i rëndësishëm në jetën ekonomike dhe financiare të vendit, Banka e Shqipërisë ka dhënë një kontribut të qenësishëm në këtë tablo zhvillimesh.

Politika jonë monetare ka rezultuar e suksesshme në përballimin e valës globale të inflacionit të viteve 2022 – 2023. Ajo mundësoi kontrollin e impaktit të kësaj goditjeje dhe rivendosjen e stabilitetit të çmimeve, me kosto minimale mbi trajektoren e rritjes ekonomike dhe stabilitetin financiar.

Mbikëqyrja dhe rregullimi i kujdesshëm i tregjeve monetare dhe i sistemit bankar, janë pasqyruar në një ambient të qetë monetar e financiar, në zhvillim të qëndrueshëm të industrisë bankare, si dhe në një rritje të shpejtë e solide të kreditimit. Gjatë vitit 2024, puna e Bankës së Shqipërisë është fokusuar në mbikëqyrjen e vazhdueshme të sektorit bankar, në përmirësimin e kuadrit makroprudencial, si dhe në rishikimin e disa rregulloreve, me fokus të veçantë në adoptimin e standardeve të Bashkimit Evropian, si dhe në rritjen e mbrojtjes së konsumatorit.

Po ashtu, puna e vazhdueshme reformatore që kemi bërë në drejtim të zhvillimit të sistemit të pagesave, ka sjellë uljen e kostos së transaksioneve bankare, rritjen e pagesave elektronike dhe zgjerimin e shkallës së përfshirjes financiare.

Së fundi, dhe po aq e rëndësishme, Banka e Shqipërisë ka përmbushur me sukses detyrat e saj ligjore për furnizimin e ekonomisë me para fizike, për administrimin e rezervës valutore dhe për prodhimin e statistikave financiare. Gjatë këtij viti, ne kemi qenë pjesëmarrës aktivë në procesin e integritetit evropian. Gjithashtu,



falë hartimit dhe miratimit të strategjive institucionale përkatëse, kemi kontribuar për rritjen e shkallës së edukimit financiar të publikut dhe reduktimin e rrezikut që industria financiare ka nga ndryshimet klimatike etj.

Këto trende pozitive zhvillimi janë një premisë inkurajuese për një zhvillim të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës të vendit në të ardhmen. Sfidat që kemi përpara nuk mungojnë, ku gjej me vend të veçoj rritjen e tensioneve dhe të pasigurisë gjeopolitike, trendet e pafavorshme demografike dhe ndryshimet klimatike. Megjithatë, progresi në adoptimin e standardeve më të mira, në rritjen e burimeve njerëzore dhe në përmirësimin e arkitekturës institucionale, ofrojnë një garanci substanciale për adresimin e tyre.

I dashur lexues,

Në mbyllje, dëshiroj t'Ju falënderoj për interesin tuaj për Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë. Jam i bindur se në të do të gjeni një analizë të plotë të zhvillimeve ekonomike, monetare dhe financiare të vendit gjatë vitit që lamë pas, një pasqyrë të punës dhe aktiviteteve të Bankës së Shqipërisë, si dhe një instrument transparence e llogaridhënieje mbi përmbushjen e objektivave tona ligjore dhe angazhimeve tona institucionale.

Me respekt,

Gent Sejko
GUVERNATOR

